



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr.816/3 Prot.

Tiranë, më 12 / 06 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 70, Datë 12 / 06 / 2019**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën me nr.60, datë 29.05.2019, të z.Xh. Zh, kundër subjekteve<sup>2</sup>: deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak “*bindjeve politike*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, Xh. Zh në parashtrimet e sjella pranë KMD-së shprehet se është përfaqësues i zgjedhur dhe i mandatuar, i autorizuar nga anëtarët themelues në funksionin e Kryetarit të Partisë “Misioni i Partisë Emigracioni Shqiptar” (PESH). Ai i ka bashkëngjitur ankesës së tij

---

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Referuar citimit të subjektit ankues në formularin e ankesës.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

dokumentacion nëpërmjet të cilit pretendon se disponon të dhëna dhe fakte që lidhen me veprime të kundraligjshme në ushtrimin e detyrës nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve, përgjegjës për shqyrtimin e çështjes në ngarkim të subjektit që ai përfaqëson.

Ankuesi ka pretenduar po ashtu se, më datë 20.04.2015 ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kallëzim penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, ndaj punonjësve të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin ende nuk ka marrë dijeni mbi fazën në të cilën ndodhet procedimi penal.

Në vijim ankuesi citon se: *“Në tagrin e përfaqësuesit politik të PESH, ai është kërcënuar, mashtruar dhe penguar për të ushtruar aktivitetin si forcë politike nëpërmjet vendimeve antikushetuese dhe diskriminuese ndaj dinjitetit dhe autoritetit të kësaj partie”*.

Në përfundim të ankesës së tij subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, dëmin moral dhe material që i është shkaktuar nga shkeljet e ligjit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i

personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për të dhënat/dokumentacionin e disponuar prej tij lidhur me kryerjen e veprimeve korruptive të prokurorëve dhe gjyqtarëve të Gjyktës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke penguar urdhërin e ekzekutimit të vendimeve penale<sup>4</sup>; Komisioneri i sugjeron atij se mund të ndjekë procedurën ligjore pranë organit të Prokurorisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjit është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë.

Po ashtu, lidhur me pretendimin e ankuesit lidhur me faktin që ndihet i kërcënuar dhe i penguar për të ushtruar aktivitetin si forcë politike, Komisioneri vlerëson se ai duhet t'i drejtohet instancave përgjegjëse që merren me trajtimin e këtyre rasteve<sup>5</sup>, pasi shqyrtimi i një fakti të tillë nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa i takon pretendimit të Xh. Zh për dëmshpërblim, Komisioneri vlerëson se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat e Tij.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

---

<sup>4</sup> Referuar citimeve të subjektit ankues në parashtrimet e sjella pranë KMD-së.

<sup>5</sup> Organit të Prokurorisë.

1. Mospranimin e ankesës së Xh. Zh, për shkak se është haptazi e pabazuar, për të bërë të mundur një hetim, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijoni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaku: Bindjet politike